



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 15
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 30 qershor 2015, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Mungoi: Njomza Emini.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 03.06.2015;
3. Raportimi i grupeve punuese;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.06.2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.06.2015, pa vërejtje.

3. Raportimi i grupeve punuese

Kryetarja - Fillimisht me lejoni t'i falënderoj për punën dhe angazhimin e tyre kryesuesit e grupeve punuese për shqyrtimin e tri projektligjeve të cilat i kemi në procedurë. Atëherë po fillojmë me raportimin e kryesuesve të grupeve punuese se pari për projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Besa Baftiu - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë. Grupi punuese për projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, siç jeni në dijeni edhe ju menjëherë mbas caktimit të grupeve punuese, ne, si grup, kemi filluar punën, deri me tani i kemi realizuar dy takime dhe e kemi shqyrtuar projektligjin nen për nen. Ne takimet tona i kemi ftuar dhe kanë qenë pjesëmarrës përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe përfaqësues nga UNICEF-i. Grupi punues ka planifikuar që ta mbajë edhe një takim javën e ardhshme dhe besoj se do të përfundojmë. Ne, si grup punues, ku do t'i procedojmë propozim- amendamentet në Komision? Kemi pasur disa vonesa pasi që përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, respektivisht kryesuesja e grupit punues që e ka përgatitur projektligjin ka qenë në pushim vjetor.

Kryetarja - Faleminderit për raportimin, a ka nevojë për ndonjë takim intensiv, ku do t'i përmbledhim të gjitha këto rekomandime në formë të amendamenteve dhe t'i procedojmë për Komision, pasi që jemi në fund të afatit ligjor për procedim në lexim të dytë. Atëherë të vazhdojmë me raportimin për projektligjin për shëndetin mendor.

Shukrije Bytyçi - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komisionit. Unë i përgëzoj për punën dhe angazhimin që po e bën stafi jonë mbështetës. Ne i kemi mbajtur dy takime pune për projektligjin për shëndetin mendor, të pranishëm ishin përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, të OSBE-së, Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës-QKRMT, si dhe përfaqësuesit e mjekësisë forenzikë. Mendoj që është bërë një punë e mirë, e kemi shqyrtuar nen për nen, kanë dalë disa amendamente. Mirëpo në kemi planifikuar që edhe një takim të mbajmë si grup punues, i kemi edhe disa çështje kontestuese dhe besoj se do e përmbyllim punën. Ne shpresoj që shumë shpejt do ta procedojmë raportin me propozim-amendamentet e grupit punues.

Kryetarja - A mendon që ka nevojë edhe për ndonjë ekspert për çështjet kontestuese që kanë dalë në grupin punues ?

Shukrije Bytyçi - Mendoj që edhe njëherë krejt grupi të mblidhemi t'i trajtojmë disa çështje që kanë mbetur kontestuese dhe të procedojmë me tej, pasi që edhe në legjislaturën e kaluar është punuar në këtë projektligj. Mendoj që është njëri prej projektligjeve që është punuar mirë dhe i plotëson kushtet dhe mund të zbatohet te ne.

Kryetarja - Besoj që do të ju hyjnë në punë edhe këto hulumtime që janë përgatitur nga Drejtoria për hulumtime dhe arkiv e Kuvendit.

Shukrije Bytyçi - Drejtoria për hulumtime dhe arkiv e Kuvendit na ka dhënë mundësi shumë të mira, duke na ofruar një hulumtim, i cili na ka dhënë me shumë informata se si rregullohet kjo çështje në disa vende të rajonit.

Besa Baftiu – Sa i përket projektligjit për shëndetin mendor, mendoj që duhet të konsultohemi edhe me ekspertë të tjerë të kësaj fushe. Një nen është diskutabil sa i përket emërimit, në vend të institutit për mjekësi psikiatri forenzike tani është klinika. Do të ishte mirë që të konsultohemi

edhe me dikë tjetër sa i përket emërimit dhe organizimit të këtyre institucioneve se si të emërtohet klinikë apo institut. Mandej Komisioni do të vendosë se a do të jetë institut apo klinikë, nën ombrellën e SHKSUK-së apo do të jetë si Institut.

Shukrije Bytyçi – Ne i kemi marrë ato vërejtje, kur të mblidhemi grupi punues, së bashku do t'i trajtojmë. Është çështja e një instituti se si po e quajnë vetën, po tash instituti ka tjetër trajtim, e klinika tjetër. Tash në këtë ligj nuk mund të shtojmë institute apo klinika që nuk janë të parapara në ligjin për shëndetësi, në ligjin bazë, ne do të shqyrtojmë në grupin punues. Po mendoj nëse është e nevojshme mund të ftojme ekspertë, por këtë çështje ne nuk guxojmë me inkorporuar institucione që nuk janë në ligjin bazë të shëndetësisë.

Kryetarja - Atëherë t'i ftojme në takim në grupin punues drejtorin SHKSUK-së, gjithashtu ekspertin që ka qenë bartës i ligjit në mandatin e kaluar, doktor Isuf Ulaj dhe të shqyrtojmë këtë problematikë. Besoj që do të kryhen në korrik këto dy projektligje.

Fadil Beka - Shumica e punës është kryer në këtë projektligj, kontributi është i gjithëve, parimisht projektligji ka qenë i mirë, nuk ka nevojë për shumë punë, kontestuese ka mbetur çështja e klinikës, institut apo qendër. U tha më herët me të drejtë se nuk përmendet në ligjin bazë të shëndetësisë, mirëpo aty nuk përmendet as klinika e mjekësisë forenzike, duhet me pasur kujdes se institucionet që kanë të bëjnë më 2 apo 3 ministri, p.sh. mjekësia forenzike ka të bëjë me Ministri të Shëndetësisë, të Drejtësisë dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, duhet me shqyrtuar mundësinë me gjetur njëfarë modusi, ndoshta me mbetur në nivelin e klinikës, atëherë mbetet pak anash. Në fakt ata kryejnë shërbime për ministrinë e lartcekura, kjo ka mbetur kontestuese. Unë pajtohem plotësisht se mundet me pasur këtu disa njerëz që kanë përvojë dhe realisht që nuk mbajnë anë. Ne e pamë atë ditë përfaqësuesin e ministrisë, me çdo kusht u mundua që objekti me mbetur klinikë, por duhet me qenë ekspert i kësaj fushe që ka përvojë në vend dhe rajon.

Kryetarja - Përveç këtyre dy personave a mendoni që duhet të jetë edhe dikush tjetër që mund të ftojme?

Besa Baftiu - Kryetare a bën të ftohet edhe drejtori i mjekësisë së forenzikës?

Kryetarja - Po bën, mund ta ftojme edhe atë.

Time Kadriaj – Sa i parkete emërimit apo organizimit, ne do t'i dëgjojmë të gjithë aktorët dhe në fund ne, si Komision, mund të vendosim se si do të emërtohen apo organizohen këto shërbime.

Fadil Beka - Pajtohem plotësisht me juve. Të ftohen drejtori i forenzikës, drejtori i SHSKUK-ë dhe dr. Isuf Hulaj si ekspert.

Kryetarja - Atëherë t'i ftojme këta për mbledhjen e ardhshme të grupit punues, vazhdojmë raportimin me projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent, urdhëro doktor Hatim.

Hatim Baxhaku - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë. Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent është me problem më të mëdha, prandaj edhe punët kanë ngecur dhe kemi më pak përparim. Siç e dini shumica prej jush kemi organizuar dëgjim publik me aktorët që janë të kyçur në këtë lëmi, sidomos Agjencinë për menaxhimin e emergjencave-MPB, drejtori i SHKSUK-së dhe drejtori i klinikës emergjente dhe drejtorët e qendrave rajonale dhe qendrave

pranë mjekësisë familjare, të cilat janë munduar të japin kontributin e vetë. Mendoj se ky ligj ka mungesë të madhe, sidomos në organizimin e shërbimit emergjent para spitalor, sepse nuk ka asnjë lidhshmëri vertikale duke filluar nga njësitë emergjente brenda qendrave të mjekësisë familjare dhe qendrave mjekësore urgjente të pavarura dhe rajonale dhe nuk as njësi qendrore të shërbimit mjekësor emergjent para spitalor se si e kanë shtetet e tjera me emërtime të ndryshme, qendra emergjente, institute emergjente, enti për shërbimin emergjent. Kurse sa i përket organizimit të shërbimit në nivelin dytësor dhe tretësor problemi ishte të qendra apo klinika për emergjencë dhe traumatologji, ishte dyshimi të quhet qendër apo klinikë, edhe aty kishte problem sepse në qoftë se do të ishte njësi e veçantë duhet të bëhet një qendër voluminoze që të ofrojë shërbime të shumta për t'i kryer punët e veta apo t'i kontraktojë punët me klinikat e tjera. Nëse bëhet e pavarur problem është pastaj kur kontrakton punë, problem që nuk mundet me i zgjidh! Mendoj që zgjidhja më e mirë është më qenë klinikë apo qendër traumatologjike në kuadër të SHSKUK-së, aspekti financiar i menaxhimit kishte me qenë më i lehtë, mirëpo ata po pretendojnë me qenë si njësi e pavarur. Mendoj që është problem me ekzistuar në atë mënyrë ashtu, sepse duhet të ketë shërbime voluminoze, si shërbime traumës, emergjencës, ortopedike, gjinekologjike, kirurgjike, internistike brenda saj duhet të ketë njësi të shumta, kjo ka implikime financiare shumë të mëdha, në këtë mënyrë nuk mund të organizohet. Ndërsa sa i përket shërbimit emergjent para spitalor edhe këtu është problem se si të organizohet qendra më e ulët, pra në nivel parësor, pastaj janë qendrat e pavarura që janë në nivel të rajoneve, pastaj nuk ka asnjë lidhje ndërmjet këtyre qendrave dhe një qendre qendrore e cila si do ta quajmë ne do të merremi vesh por tani nuk ekziston asnjë qendër e tillë. Nuk është përcaktuar numri specifik i thirrjeve, tash është 112, por ky është në kuadër të policisë dhe 112 nuk kanë asnjë ekspert mjekësor në kuadër të qendrave operative, ata pas thirrjeve i drejtohen qendrës mjekësore rajonale, pastaj fillon kështu zinxhiri, ose kjo mund të bëhet me një kombinim që këto qendra operative me pas aty edhe një ekip mjekësor i përbërë nga mjeku dhe infermieri, i cili do t'i pranojë thirrjet. Ky projektligj është me probleme të mëdha, mendoj që nuk është i papërgatitur mirë nga ana e ministrisë, apo jo? Ndoshta kanë qenë të ngushtuar nga aspekti financiar dhe janë munduar me bërë një ligj sa më të përshtatshëm kushteve ekzistuese të strukturave të shërbimeve shëndetësore. Mendoj që ky ligj kërkon më tepër punë, duhet të takohemi me Ministrin e Shëndetësisë, të Financave, me Agjencisë së emergjencave në mënyrë që se bashku të shqyrtojmë dhe të evitohen ato defekte që mund të jenë.

Time Kadrijaj - Faleminderit kryetare, pajtohem me kryesuesin e këtij grupi punues, kjo ka qenë arsyeja që grupi i jonë parlamentar nuk e ka votuar as në lexim të parë. Bile kam bërë thirrje të grupet e tjera parlamentare për të mos e votuar. Neve na ka ndodhur si komision edhe më herët, kemi punuar me një projektligj deri në fund dhe në fund e kanë tërhequr, gjë që nuk ka logjikë e as kuptim, se atëherë nëse dëshirojnë me tërheq mund ta tërheqin edhe në këtë moment. Ne kemi mbajtur dëgjimin publik dhe nga dëgjimi publik jam ndarë shumë e zhgënjyer atë ditë, prej aktorëve aty asgjë konkrete nuk na kanë dhënë, janë marrë me gjëra terciare e nuk janë marrë me gjëra primare se cili do të jetë ballafaqimi gjatë kryerjes së punës së tyre. Neve na duhet një përkushtim i madh për ta sjellë në binarë këtë projektligj, por sa është e logjikshme në momentin që ndryshon prej aktualit mbi 40 % atëherë duhet të sillen një projektligj i ri. Ministria e Financave i ka dhënë mendimet për kosto buxhetore, është ndoshta në fillim me u kthyer ky projektligj në ministri dhe ata me punuar dhe përsëri të sillen.

Kryetarja - Përfundimi është që të bisedojmë me ministrin, dhe të diskutojmë këtë çështje.

Fadil Beka - Ashtu siç tha edhe dr. Hatimi me thënë të drejtën se krejt problemi i emergjencës dhe i krejt ligjit është se si të sillen i sëmuri sa më shpejt në spital. Këtu është hallka kryesore se kur të vjen në spital, mirë- keq këto kuadro që i kemi, pra nuk është problem. Pra, krejt problemi

është si të sillet i sëmuri në spital, sa është stafi i përgatitur, vjen pa vija venoze apo me gjakderdhje askush nuk ka tentuar me ja ndalur, edhe kirurgët më të mirë në botë nuk mund të bëjnë asgjë. U ngritë edhe çështja e shërbimit terciar, problemi është çka me i bërë vijës së parë, paramedikët, ne jemi dëshmitarë se kur ta bien KFOR-i një të aksidentuar, e bien krejt të përpunuar. Neve po ndodh po na vdesin njerëzit rrugës, po vdes se nuk po mundesh me shkuar me i dhënë ndihmë, aty është krejt esenca, aty duhet me qenë krejt përpjekjet, shumë vende i kanë paramedikët, ai organizim duhet me qenë. Kur shërbimi është emergjencë duhet me qenë në gjendje gatishmërie për raste emergjente dhe ai ekip duhet me shkuar në vendin e ngjarjes.

Kryetarja - Në këtë projektligj, a ju duket doktor se ka tendencën me u shndërruar në klinikë?

Fadil Beka - Ne ato tendenca po i eliminojnë, nuk po merremi me to. Në parim ja kemi dhënë vizën.

Kryetarja - Po merremi se kjo është krejt përmbajtja e këtij, po pretendon me qenë klinikë, e jo me ja ofruar më parë ndihmën profesionale pacientit.

Fadil Beka - Edhe ky shërbim është mirë me pasur një komandë, nuk mundemi me lënë pa e qenë aty, iku një piramidë për këto shërbime. Edhe qendrat dispiqerike që po përmenden gjithsesi duhet me tentuar me bërë një numër unik, jo policia tjetër, emergjenca një tjetër. Nëse thërras unë në telefon atë lajm ka me dëgjuar policia, emergjenca, zjarrfikësit, do ta dëgjojnë të gjitha rajonet dhe kush është më së afërmi do të merret me rastin.

Kryetarja - Ne mund ta bëjmë prej fillimit projektligjin, por sa na duhet kemi fuqi dhe kapacitet dhe a e kemi atë forcë, nëse duam edhe mundemi, sepse këtu ka njerëz që e njohin këtë lëmi, e kanë mbajtur këtë barrë edhe në kohën e vështira, por disa edhe sot, prandaj ndoshta edhe mund ta ndryshojmë në të mirë. Pas takimit me ministrin do ta vendosim se si të veprojmë.

Shukrije Bytyçi - Desha me u ndërlidh te ligji për emergjenca, vërtet është shumë i mangët ndoshta ishte një hap i ngutshëm se e rekomandua për Kuvend, kemi mundur ta ndalojmë këtu, mandej nuk e votuam në seancë, tani e tutje duhet të bëjmë punë, edhe neve nuk na intereson se si është emri, pajtohem me doktor Fadilin, neve na intereson të kryhet shërbimi, me qenë ndërlidhja se pa marrë parasysh ku është vendi, çështja e bartjes është pra njëra prej problemeve. Edhe unë pajtohem se ta ftojme ministrin se mos të bëjmë punën kot, e mandej të shohim se si të veprojmë.

Kryetarja - Kur është puna të emri unë nuk mundem me u pajtuar se nuk është i rëndësishëm, se emri e determinon se cili është funksioni, detyrat. Pra klinika është tjetër, e qendra tjetër. A po pajtoheni që ta vazhdojmë këtë javë projektligjin për mbrojtjen dhe të ushqyerit me qumësht gjiri dhe shëndetin mendor dhe ta shohim se a kemi nevojë për konsultim të përbashkët.

Shukrije Bytyçi - Kisha propozuar që të mblidhemi në koordinim me deputeten Besën që njëra të jetë të hënën dhe tjetra të martën. Pra, kisha kërkuar që të jenë të pranishëm të gjithë që ta japim më të mirën e mundshme.

Kryetarja - U pajtuam, ndërkaq për projektligjin për emergjenca do të diskutojmë më tutje.

4. Të ndryshme.

Kryetarja - Kemi marrë një material nga Fakulteti i Mjekësisë për themelimin e Universitetit Mjekësor në Prishtinë, është një kërkesë e nënshkruar nga 184 mjekë profesionistë me tituj profesorë, asistentë. Kuvendi i Kosovës e ka themeluar Universitetin e Prishtinës, të ju them të drejtën nuk e kam shumë të qartë kërkesën dhe a jemi ne kompetentë që ta themelojmë këtë universitet. Atëherë kjo kërkon një studim më të madh, kam nevojë më u konsultuar me propozuesit e kësaj kërkesë. Edhe këtu hyn në punë Ministria e Arsimit se nëse është për shkencë ajo e ka fondin për shkencë, ndërsa nëse është si institut për hulumtime shkencore nuk e kam të qartë, prandaj po e lejmë si debat që të diskutohet më tutje. Shpresoj ta kemi së shpejti elaboratin që e kanë sjellë dhe do ta dimë pastaj a është shkencore apo shëndetësore, nëse është hulumtuese dhe mjekësore na takon, pa marrë parasysh që është arsimore sepse na intereson çka duan këta.

Shukrije Bytyçi - Kjo është në kompetencë të Ministrisë së Arsimit. Unë jam në Komision të arsimit, kjo çështje ende nuk ka ardhur te ne.

Time Kadrijaj - Nëse Kuvendi i Kosovës ka qenë themelues i UP-së, a do ta themelojë edhe këtë universitet ?

Hatim Baxhaku - Universitet tash do të themelohen në bazë të ligjit për arsim të lartë, si deputet neve na intereson, por si Komision nuk na takon.

Fadil Beka – Kjo, si thatë ju, edhe ne, si deputetë, ta kemi si informatë, ata propozues i kanë edhe arsyet e veta, ka shumë shtete që kjo është e ndarë si universitet, diku quhet universitet bio-mjekësor, diku mjekësor. Në fakt janë 4 apo 5 fakultete aty ndoshta në parim nuk është diçka keq edhe nëse bëhet universitet, sa e di unë Fakulteti i Mjekësisë është i hendikepuar nga Rektorati sepse është më 5 fakultete dhe përfaqësimi është i njëjtë sikur ai që është më një fakultet. Ankesat janë se nuk po e kupton askush problematikën e Fakultetit të Mjekësisë në Rektorat, po e përfaqëson p.sh. një i Fakultetit të Artit. Ai mundet me qenë shumë i zoti, por nuk e njeh mjekësinë, aty janë problemet, është ndër më të mëdhenjtë, por përfaqësohet njëjtë.

Shukrije Bytyçi - Propozuesit i kanë arsyet e tyre, ne te Komisioni i arsimit jemi në plotësim-ndryshim të ligjit për arsim të lartë dhe këta ndoshta e kanë gjetur kohën më ardhur. Ne duhet t'i shqyrtojmë kërkesat edhe të çdo qytetari me të thjeshtë se jemi përfaqësues të tyre, por si kërkesë është me shqyrtuar më shumë Komisioni për arsim. Personalisht nuk kam ndonjë mendim, ne duhet me u takuar edhe me parashtruesit e kërkesës.

Kryetarja - Faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA